



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2270, datë 13.02.2013**

**Për**

**“ Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Autorizimet Individuale para bashkimit me përthithje të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a tek subjekti tregtar përthithës Albtelecom sh.a.”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 13.02.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” shqyrtoi çështjen me objekt:

**“ Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Autorizimet Individuale para bashkimit me përthithje të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a tek subjekti tregtar përthithës Albtelecom sh.a.**

## BAZA LIGJORE:

1. Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008, neni 13 e vijues, neni 74, neni 114 dhe neni 115 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji 9918/208**);
2. Ligj nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**);
3. Ligj nr. 9901, date 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” , i ndryshuar ;
4. Rregullore nr 24,dt 02.02.2012 “ Për Autorizimin e Përgjithshëm”.
5. Rregullore nr.4,dt.23.01.2013 “ Per Autorizimin Individual”.

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- **Shkresat e sipërmarrësit Altelecom** (Nr. 533,Prot., datë 31.01.2013, dhe dokumentet Bashkëngjitur),
- **Relacionin dhe p/VKD** e përgatitur nga Drejtoria Juridike, Drejtoria e Rreg.Teknik, dhe Drejtoria e Rreg. Ekonomik si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar.

## V Ë R E N:

Në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare është depozituar shkresa e Altelecom sh.a nr. 533,dt.31.01.2013 “ *Kërkesë për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të Eagle Mobile sh.a tek subjekti tregtar përthithës Altelecom sh.a*” në vijim të korrespondencave të mëhershme në lidhje me transaksionin e miratuar paraprakisht nga AKEP në tregun e Komunikimeve Elektronike (*shih VKD nr.1872,dt11.04.2012*) nëpërmjet bashkimit me përthithje midis Eagle Mobile sh.a tek Altelecom sh.a.

Kësaj kërkesë sipërmarrësi Altelecom sh.a i ka bashkëngjitur edhe një kopje të ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “ Altelecom sh.a” lëshuar nga QKR.

AKEP, bazuar ne ligjin nr. 9723, dt.3.5.2007 “*Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit*” ka vërejtur pasqyrimin e Çështjes *CN-999051-01-13* me dt.31.01.013 “ *Miratim i bashkimit me përthithje*” në bazë të procesverbalit të mbajtur nga Asambleja e Aksionerëve te Altelecom sh.a.

Vendimi i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të aksionerëve të shoqërisë anonime Altelecom sh.a ka miratuar përfundimisht transaksionin tregtar të Bashkimit me Përthithje të

shoqërisë Eagle Mobile sh.a nga Albtelecom sh.a ( *p/verbal dt.24.01.2013*), duke miratuar Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje dhe raportin e Drejtorit të Përgjithshëm të Albtelecom dhe Eagle Mobile z.O.Coskun, duke miratuar Statutin e ri të shoqërisë Albtelecom pas bashkimit me përthithje si dhe miratimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës të Albtelecom sh.a pas bashkimit me përthithje.

AKEP me vendimin e datës 11.04.2012 ka dhënë pëlqimin dhe dakortësinë e tij për transaksionin e pritshëm asokohe në tregun e KE duke vlerësuar dhe konsideruar edhe Vendimin e Komisionit të Konkurrencës, në mënyrë që të krijonte bindje dhe të sigurohej se transaksioni nuk krijonte deformime në konkurrencë, si: “Për disa rekomandime AKEP-it në lidhje me tregun e komunikimeve elektronike” (shkresë nr. 1948, dt.27.12.2011).

Aktualisht ky transaksion tregtar i bashkimit me përthithje është materializuar duke u bërë tashmë fakt juridik i mbështetur në dispozitat normative të ligj nr. 9901, me ndryshime, *KREU I*, neni 216 e vijues i tij, AKEP si organi rregullator kompetent, ndër të tjera, për kryerjen e rregjistrimit të sipërmarrësve të rrjeteve dhe komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit të tyre, si organi që lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike, si autoriteti rregullator që përcakton sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, ka detyrimin ligjor të realizojë kalimin e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në ushtrimin e veprimtarisë së tij rregullatore nga sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a tek sipërmarrësi Albtelecom sh.a.

Ky kalim juridik i të drejtave dhe detyrimeve të subjektit tregtar pas realizimit të bashkimit me përthithje që ka ndodhur është “*de facto*” një natyralizim i tagreve ligjore dhe tregtare nëpërmjet shoqërisë së përthithur dhe shoqërisë përthithëse efektive, ndërsa trajtohet “*de jure*” si kalimi i të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë së përthithur Eagle Mobile sh.a tek shoqëria tjetër ekzistuese në cilësinë e shoqërisë përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie.

AKEP, gjatë ushtrimit të pushtetit diskrecional dhe vendimtar ka arsyetuar në mënyrë ligjore dhe administrative të mbështetur në ligj dhe fakte Vendimet e Këshillit Drejtues prej të cilave burojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e këtyre dy sipërmarrësve në akte të veçanta rregullatore, si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale të tyre, këto të drejta dhe detyrime duhet të transferohen mbështetur në dispozitat ligjore (*L 9918/2008, neni 74*), kur për kalimin e tyre ka një interes të shprehur në AKEP nga shoqëria përthithëse që zotëron 100% të aksioneve dhe kapitalit të shoqërisë së përthithur nga bashkimi.

- *Në mënyrë që të garantohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient, i spektrit të frekuencave, numrave dhe serive numerike AKEP do të miratojë kalimin e këtyre të drejtave dhe detyrimeve të Eagle Mobile sh.a tek Albtelecom sh.a, të rregulluara në aktet përkatëse të nxjerra individualisht nga AKEP, sipas Lidhjeve që do t'i bashkëngjiten këtij vendimi.*
- *Në mënyrë që të ruhet dhe të mbrohet konkurrenca në tregun e komunikimeve elektronike, AKEP do të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara tek Albtelecom sh.a nga Eagle Mobile sh.a si sipërmarrës me FNT në tregun përkatës si “tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të*

*Eagle Mobile sh.a*” sipas VKD nr.2120, dt.4.07.2012, si dhe të drejtat dhe detyrimet e caktuara Eagle Mobile sh.a si sipërmarrës me FNT në tregun përkatës si “*Tregun me shumicë të terminimit të mesazheve SMS në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Eagle Mobile*” sipas VKD nr. 1711 datë 31.10.2011.

- *Në mënyrë që proçesi i perthithjes të jetë i plotë dhe ti shërbeje qëllimit të palëve, AKEP do të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a në VKD nr.1267, date 28.04.2010 “Miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) se Eagle Mobile sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”, i ndryshuar, tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a , kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a në VKD nr.2177, datë 29.10.2012 “Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a” si dhe do të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a, në çdo akt tjetër të AKEP dhe zëvendësimin e emrit Eagle Mobile sh.a me Albtelecom sh.a në çdo dokument tjetër të miratuar me aktet respektive të AKEP.*
- *Në mënyrë që proçesi i përthithjes, të ruajë dhe mbrojë parametrat e vendosura në treg për orientimin e tarifave drejt kostos, dhe shmangien e përdorimit të tarifave antikonkurruese apo abuzive, AKEP bazuar në nenin 8.11) të ligjit 9918/2008 dhe mbështetur në ligjin nr.9121,dt.28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës” do të mbikqyrë dhe monitorojë në vijimësi zbatimin dhe respektimin e kërkesave ligjore për tarifata e shërbimeve elektronike që do të ofrojë Albtelekom sh.a nëpërmjet ofertave të aplikueshme në treg.*

*Si përfundim, ky qëndrim miratues i AKEP për kalimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të caktuara për Eagle Mobile sh.a në aktet rregullatore dhe individuale të nxjerra nga AKEP dhe në fuqi tek shoqëria tregtare përthithëse Albtelecom sh.a materializon në mënyrë përfundimtare administrative personalitetin juridik-tregtar të shoqërisë anonime Albtelecom sh.a përpara Autoritetit Rregullator, në tregun e komunikimeve elektronike dhe në marrëdhënie me palët e tjera.*

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, i ndryshuar, K.Pr.A, dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*”,

## **V E N D O S:**

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

Fax : + 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

1. Të miratojë kalimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit GSM 900 dhe GSM 1800 sipas aneksit të Autorizimit Individual, miratuar me VKD Nr.532, datë 26.12.2008, nga Sipërmarrësi "Eagle Mobile" sh.a tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a. (*sipas Lidhjes nr.1,bashkëngjitur*).
2. Të miratojë kalimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave për lidhje fikse radio, sipas anekseve të Autorizimit Individual miratuar me VKD Nr.2219, datë 28.12.2012, nga Sipërmarrësi "Eagle Mobile" sh.a tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a. (*sipas Lidhjes nr. 2, bashkëngjitur*)
3. Të miratojë kalimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 1950–1965 MHz çiftuar me 2140-2155 MHz dhe 1910-1915 MHz spektër i paçiftuar, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, për të ofruar shërbime të lëvizshme tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë", miratuar me VKD Nr.2215, date 17.12.2012, nga Sipërmarrësi "Eagle Mobile" sh.a tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a. (*sipas Lidhjes nr.3,bashkëngjitur*).
4. Të miratojë kalimin e të drejtave të përdorimit të numrave dhe serive numerike, nga Sipërmarrësi "Eagle Mobile" sh.a tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a. (*sipas Lidhjes së Numeracionit, bashkëngjitur*).
5. Të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a në VKD nr.1267, date 28.04.2010 "*Miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Eagle Mobile sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme*", i ndryshuar, tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a , dhe zëvendësimin e emrit Eagle Mobile me Albtelecom në kontratën e miratuar me këtë vendim .
6. Të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a në VKD nr.1711 datë 31.10.2011 "*Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në: Tregun me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetin publik të telefonisë të lëvizshme Eagle Mobile*" tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a.
7. Të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a në VKD nr.2120, dt.4.07.2012 "*Përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese*" tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a.
8. Të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a në VKD nr.2177, datë 29.10.2012 "*Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a*" tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a, dhe zëvendësimin e emrit Eagle Mobile me Albtelecom në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të miratuar me këtë vendim.

9. Të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a tek sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a, në çdo akt tjetër të AKEP dhe zëvendësimin e emrit Eagle Mobile sh.a me Albtelecom sh.a në çdo dokument tjetër të miratuar me aktet respektive të AKEP.
10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Albtelecom sh.a të kryeje përditësimet e nevojshme sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
11. AKEP do të mbikqyrë dhe do të monitorojë në vijimësi respektimin e kërkesave ligjore për tarifat e shërbimeve elektronike që do të ofrojë Albtelekom sh.a nëpërmjet ofertave të aplikueshme në treg.
12. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE